VENDIM
Nr. 525, datë 27.9.2017

PËR SHPËRNDARJEN DHE DETAJIMIN E FONDIT TË INVESTIMEVE PËR FUNKSIONIN E UJITJES DHE TË KULLIMIT PËR BASHKITË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 16, të ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërndarjen dhe detajimin e fondit të investimeve për skemat ujitëse, me vlerë 380 000 000 (treqind e tetëdhjetë milionë) lekë, sipas bashkive, dhënë në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Tepricat eventuale të prokurimeve të fondit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi rishpërndahen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministri Brendshëm, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Tabela 1. Fondi për rehabilitimin e skemave ujitëse sipas bashkive.

Bashkia	Emërtimi i projektit	Vlera në lekë
	Total	**380 000 000**
Tiranë	Rehabilitimi i pjesshëm i skemave ujitëse dhe sifonave te Mustafa Kow, Rove (Ballcflik), Alltate	10 000 000
Vlorë	Skema ujitëse, rezervuar Kallafet, Sherishte, Kanine, Alikoke	10 000 000
Finiq	Skema ujitëse SRU-4, kanali ujitës K-K-2 "ALIKO"	10 438 443
Sarandë	Rikonstruksion i kanalit ujitës 17-S2 (Lugjeve)	16 975 200
Konispol	Skema ujitëse SR - U - 2, kanali V55	11 666 660
Delvinë	Rikonstruksion i pjesshëm i kanalit ujitës K-K-5 Bajkaj - vazhdim	8 960 000
Gjirokastër	Rehabilitimi i skemave ujitëse GJU 4, GJU4/4, GJU 5, kanali vaditës V3 -vazhdim	9 000 000
Tepelenë	Rehabilitimi i kanalit ujitës Gusmar	21 787 602
Këlcyrë	Rehabilitimi i skemës ujitëse të rezervuarëve - Këlcyrë dhe Varibop	19 206 600
Elbasan	Sifon i k. ujitës Letan-Gurabardh	12 000 000
Elbasan	Sifon i k. ujitës Vreshtan-Shushicë	8 000 000
Korçë	Rehabilitimi në kanalet ujitëse sekondare të rezervuarit Gjanç	40 000 000
Maliq	Portbarazhi kolektori i Sovjanit	5 800 000
Kolonjë	Kanali ujitës, Përroi Qinam (ERU-V30)	13 000 000
Pogradec	Rezervuari Frangovisht+Hykollaret	10 069 305
Ura Vajgurore	Rikonstruksioni Ura Vajgurore-Poshnjë dhe *Bypass* Ciflik	14 999 842
Dibër	Faza II e kanalit Sifoni Brezhdan-Vakuf	3 240 000
Dibër	Rikonstruksioni i kanalit Llixha-Brezhdan dhe Gurra-Venisht	13 575 966
Shijak	Rehabilitimi i skemës ujitëse Maminas	11 119 002
Has	Rehabilitimi i ushqyesit të rezervuarit Fajza	7 670 000
Tropojë	Rikonstruksioni i kanalit të Gashit, faza I	10 000 000
Fier	Rehabilitimi i kanalit ujitës, dega e Fierit (Skema e ujitjes FRU-1)	9 500 000
Fier	Rehabilitimi i kanalit ujitës, dega e Dermenasit (Skema e ujitjes FRU-1)	9 000 000
Roskovec	Rehabilitimi i pjesshëm i rrjetit në zonën Suk 1, Roskovec (vazhdim)	14 975 132
Lushnjë	Rehabilitimi i kanalit ujitës, fshati Plug	14 529 831
Kurbin	Ndërhyrje në kanalet sekondare të U12	16 497 828
Mirditë	Rehabilitim i kanalit ujitës, dalje tuneli Malaj-1 - Tene (Ujëmbledhësi Malaj-1 2.35 milionë m^3 ujë)	20 488 589
Fushë-Arrëz	Rikonstruksion i kanalit ujitës Ferrcoj - Lulaj, fshati Kryezi	12 500 000
Malësia e Madhe	Skema ujitëse me rehabilitimin e kanaleve sekondare të Shtodrit	15 000 000